

Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes

Arkiva është njësi strukturore e nënstrukturore e institucionit që evidenton, ruan, përpunon dhe vë në shfrytëzim dokumentet e krijuara prej tyre.

Baza ligjore

Bazuar në Ligjin 9154, datë 06.11.2003, për “Arkivat”, respektivisht neneve 23, 24, Kreut VI.

Dorëzimi i dokumenteve në Arkivat Shtetërore, neneve 42, 43, 44.

Bazuar në Normat Tekniko-Profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, Kreu 1, nenet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 17, 18, 19, 20, 25.

Ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve në nenet 32, 33, 34, 35.

Ruajtja e dokumenteve nenet 41, 42, 44, 45.

Në Arkiv kryhen veprimet e mëposhtme:

- Bashkërendohet puna me Protokollin,
- Bëhet përpunimi tekniko-shkencor dhe ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve, organizohet puna për shfrytëzimin e dokumenteve për plotësimin e kërkesave operative duke hartuar për këtë qëllim edhe mjete të ndryshme informative,
- Përgatitet për shqyrtim lista e veçimit për asgjësimin e dokumenteve që kanë plotësuar afatin e ruajtjes,
- Bëhet dorëzimi në arkivin qendror të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare që kanë plotësuar kohën e qëndrimit pranë arkivit të subjektit shtetëror,
- Organizohet puna për përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve që kanë hyrë në arkiv të pasistemuara.

Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes

Lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve në **Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni” Tiranë.**

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9154, dt. 06.11.2003 “Për Arkivat”; “Normat Tekniko-Profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”; “Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK)” dhe lista me afat ruajtje të përkohshme, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Bazuar në strukturën dhe organogramën e **Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gligozi” Tiranë**, Komisioni i Ekspertizës, miraton listën konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK) dhe dokumenteve me afat ruajtje të përkohshme, sipas modelit dhe në përputhje me listën “Tip” me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Lista konkrete miratohet edhe nga titullari i institucionit.

Në dokumentet me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK) janë të gjitha aktet që kanë vlerë ruajtje të përhershme dhe shpallen si të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe në to mund të bëjnë pjesë:

- Ligje, vendime, udhëzime, plane, studime, evidenca përmbledhëse statistikore,
- Dokumente për krijimin, organizimin, riorganizimin dhe funksionimin e institucionit shëndetësor,
- Dokumente për rregulloret e brendshme tip të institucionit,
- Dokumente për numrin dhe shtrirjen e personelit mjekësor,
- Dokumente për luftën kundër korrupsionit,
- Dokumente mbi kontrollin e KLSH dhe DSUKSH, propozime, detyra, zbatim i detyrave të lëna,
- Dokumente për organizimin e konferencave, aktiviteteve shkencore, simpoziumeve, konsultave, seminareve kombëtare ose ndërkombëtare,
- Dokumente për cilësinë, sigurinë, akreditimin dhe vlerësimin institucional,
- Dokumente për strukturën organizative, kategorizimin dhe fondin e pagave,
- Dokumente për konkurset për vendin e punës,
- Dokumente për emërimet, transferimet të personelit mjekësor,
- Dokumente për degën juridike, për prokurimet publike dhe tenderat,
- Dokumente lidhur me njësienë e auditimit, plane, projekte, relacione,
- Dokumente për metodologjinë statistikore dhe informacionit,
- Dokumente për hartimin dhe zbatimin e buxhetit,
- Dokumente mbi treguesit e kostos mujore dhe vjetore,
- Dokumente nga Shërbimet Mjekësore,
- Dokumente nga Programet Kombëtare shëndetësore dhe kontrolli i infeksioneve.